

---

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË "STAR CASINO" SHA

## 1. EMRI DHE FORMA LIGJORE E SHOQËRISË

Emri i shoqërisë do të jetë **"STAR CASINO" SHA**, nga këtu e mëposhtë referuar si "shoqëria". Shoqëria është e organizuar si shoqëri tregtare e formës aksionare (SHA).

## 2. AKSIONARET E SHOQËRISË

Shoqëria është themeluar aksionarët:

- **Z. Enklajd Malo**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 13.10.1985, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. personal I51013044C;
- **Z. Hauard Malo**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 23.12.1995, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. personal J512230470.

## 3. SELIA E SHOQËRISË

- 3.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: *Rruga "Ismail Qemali", Pallati 11, Kati 2, ne krah te Radio Televizionit Shqiptar, Tirane, Shqipëri.*
- 3.2 Shoqëria mundet të shtrijë aktivitetin e vetë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e lejuar në legjislacionin në fuqi. Ajo mundet të themelojë degë, ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë tij.
- 3.3 Selia e shoqërisë mundet të transferohet kudo brënda territorit të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e lejuar në legjislacionin në fuqi. Ky transferim kryhet me vendimmarrje të Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë.

## 4. OBJEKTI I AKTIVITETIT

Shoqëria mund të kryejë në Republikën e Shqipërisë, çdo aktivitet që nuk ndalohet nga ligji në fuqi, të tillë si, por pa u kufizuar në:

---

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është organizimi dhe kryerja e aktivitetit që lidhet me Kazinotë dhe me lojrat e fatit. Shërbime kembimi valutor brenda ambienteve të Kazinosë, në përputhje me dispozitat ligjore rregullatore në fuqi. Trajnimi i stafit të ri apo ekzistues të Kazinosë për qëllime të aktivitetit të Kazinosë me synimin e punësimit të një stafi të kualifikuar. Shërbime restoranti dhe bar brenda ambienteve të Kazinosë dhe vetëm për vizitorët e tij. Import-eksport të pajisjeve dhe të materialeve lidhur me kazinotë dhe lojrat e fatit. Çdo aktivitet tjetër lidhur me kazinotë dhe me lojrat e fatit në përputhje të plotë me legjislacionin e zbatueshëm.

## **5. KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT**

- 5.1 Periudha e aktivitetit të shoqërisë është **me afat të pacaktuar**, afat i cili fillon nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).
- 5.2 Çdo ndryshim në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

## **6. KAPITALI THEMELTAR**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) Lekë**.
- 6.2 Kapitali themeltar është ndarë në 2 (dy) aksione, secili me vlerë nominale 1.750.000 (një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.
- 6.3 Pjesëmarrja aksionarëve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:
- **Z. Enklajd Malo: 50% (pesëdhjetë përqind);**
  - **Z. Hauard Malo: 50% (pesëdhjetë përqind).**

## **7. ORGANET VENDIMARRËSE TË SHOQËRISË**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme.
- b. Administratori.
- c. Këshilli Administrim.

## **8. ADMINISTRATORI.**

- 8.1 Administratori i shoqërisë është:

- 
- **Z. Enklajd Malo**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 13.10.1985, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. personal I51013044C.

8.2 Mënyra e emërimit, e shkarkimit, të drejtat dhe detyrimet e administratorit, si dhe koha e qëndrimit në detyrë të tij përcaktohen në Statut dhe në ligj.

## 9. KËSHILLI I ADMINISTRIMIT.

Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë:

- **Z. Andi Merepeza;**
- **Z. Alban Kondi;**
- **Z. Aldi Malo.**

## 10. MBYLLJA (LIKUIDIMI) I SHOQËRISË

Në rast të falimentimit të kompanisë, procesi i likuidimit do të realizohet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi në momentin e falimentimit.

### AKSIONARËT

**Enklajd Malo**

**Hauard Malo**

**Tiranë, më 12/04/2025**